

V E N D I M
Nr. 737, datë 28.12.2000

**PËR PËRCAKTIMIN E TERMAVE DHE TË KUSHTEVE TË BONOVE TË THESARIT,
PËR DETYRIMIN E SHETIT DHE PËR RIKAPITALIZIMIN E BANKËS SË
KURSIMEVE, SH.A.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 3 të ligjit nr.8726, datë 26.12.2000, "Për mbulimin me bono thesari të detyrimeve të shtetit kundrejt Bankës së Kursimeve dhe rikapitalizimin e saj me bono thesari", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Detyrimi i shtetit kundrejt Bankës së Kursimeve, sh.a, për shumat 7 607 milionë lekë dhe 9 640 milionë lekë të bëhet nëpërmjet emitimit të bonove të thesarit, sipas termave, kushteve dhe karakteristikave të mëposhtme:

- | | |
|------------------------------|--|
| a) Emetuesi: | - Ministria e Financave |
| b) Lloji i letrave me vlerë: | - Bono thesari |
| c) Forma e emitimit: | - Me vlerë të skontuar në një regjistër të veçantë, pranë Bankës së Shqipërisë |
| ç) Data e emitimit: | - 29 dhjetor 2000. |
| d) Shuma e emitimit: | - 17 247 milionë lekë, me prerje të tregtueshme 100 milionë lekë |
| dh) Afati i maturimit: | - 6 muaj, me të drejtë rinovimi. |
| e) Norma e interesit: | - e barabartë me nivelin mesatar të YILD-it të bonove të thesarit, me afat maturimi 6-mujor, të ankandëve më të afërta, para dhe pas datës 29 dhjetor 2000, për periudhën e investimit. Pas kësaj periudhe bonot e thesarit do të riinvestohen gradualisht në ankandet e radhës. |
| f) Tregtueshmëria: | - Bonot mund të shiten apo të skontohen nga mbajtësi, sipas zhvillimit të gjendjes monetare dhe pozicioneve të likuiditeteve të sistemit bankar, në përgjithësi, dhe të bankave, në veçanti, por jo më përpara se data dy muaj pas datës së emitimit të tyre. |

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta